



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 24 maj 2021
Nr. ref.:RK 1784/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI89/20

Parashtrues

Skender Bislimi

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit Pml. nr. 351/2019 të Gjykatës Supreme,
të 26 dhjetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Skender Bislimi nga fshati Glamnik, komuna e Podujevës, me banim në Krushevc, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga avokatët Miro Delević dhe Nebojša Vlajić nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin Pml. nr. 351/2019 të Gjykatës Supreme, të 26 dhjetorit 2019.
3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i është dorëzuar avokatit të parashtruesit të kërkesës Nebojsa Vlajić, më 10 janar 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], neni 5 [Gjuhët], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 9 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata), ku thekson se *“duke u bazuar në vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kjo ankesë është parashtruar pas afatit të caktuar me ligj për shkak të pandemisë, sëmundjes COVID19”*.
7. Më 12 qershor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 2 korrik 2020, Gjykata i njoftoi avokatët e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që Gjykata Supreme t'i dorëzojë asaj prova nëse dhe kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës apo avokatëve të tij aktgjykimi i kontestuar Pml. nr. 351/2019 i Gjykatës Supreme, në gjuhën serbe.
10. Gjykata Supreme nuk iu përgjigj kërkesës së Gjykatës të 2 korrikut 2020.
11. Më 26 gusht 2020, Gjykata i dërgoi një letër të re Gjykatës Supreme me të njëjtën kërkesë.

12. Më 28 gusht 2020, Gjykata Supreme iu përgjigj kërkesës dhe i dërgoi të gjitha informacionet dhe provat e kërkuara Gjykatës.
13. Më 25 mars 2021, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 6 janar 2017, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ngriti Aktakuzën SPP. nr. 85/2011 në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Vepra të Rënda Penale (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) kundër parashtresit të kërkesës për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale *“Krimi i luftës mbi popullatën civile, sipas nenit 22 dhe 142 të Ligjit penal të Republikës Socialiste të Jugosllavisë, e cila aktualisht është e dënueshme sipas nenit 31 dhe 152 të Kodit Penal të Kosovës, me shkeljen e nenit të përbashkët nenit 3 të Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe shkeljes së nenit 4 dhe 5 të Protokollit 2 të 8 qershorit 1977”*.
15. Më 25 tetor 2018, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin TKD. nr. 3/17, me të cilin e shpalli parashtresin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale të përshkruar në Aktakuzën e Prokurorisë Speciale, SPP. nr. 85/2011, të 6 janarit 2017. Rrjedhimisht, të njëjtit edhe i shqiptoi dënim me burgim prej 10 (dhjetë) vitesh.
16. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore thuhet: *“Gjykata pas procedurës së provave, analizimit të secilës provë veçmas dhe të të gjithave së bashku, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, kjo gjendje faktike është vërtetuar në bazë të dëshmisë së dëshmitarëve dhe provave materiale të cilat janë paraqitur në shqyrtimin gjyqësor, të konstatuar në fakte konkrete të cilat janë provuar sa i përket veprës penale e cila i vihet në barrë të pandehurit.*

Gjykata me një vëmendje të veçantë ka analizuar mbrojtjen e mbrojtësve të të pandehurit dhe mbrojtjen e vet të të pandehurit, e cila konsiston në atë që alibia e tyre që i pandehuri Skender Bislimi në kohën kur, siç përshkruhet në dispozitiv të këtij aktgjykimi, së bashku me familjen e tij gjendej në Serbi dhe atë në qytetin e Krushevcit. Me atë rast ka paraqitur një provë materiale siç është certifikata e lindjes e fëmijës e cila në vete nuk e konteston faktin se i pandehuri ka qenë në vendin e krimit ...”

17. Avokatët e parashtresit të kërkesës paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, TKD. nr. 3/17, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të lartësisë së dënimit të shqiptuar.
18. Më 20 gusht 2019, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PAKR nr. 341/2019, me të cilin i refuzoi ankesat e avokatëve të parashtresit të kërkesës si të pabazuara. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit thuhet:

“Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale procedurale të ligjit penal, si dhe shkeljen e dispozitave të nenit 377, paragrafi 7 të KPK-së, Gjykata e Apelit deklaroi se ajo ka shqyrtuar me kujdes aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe ankesat e mbrojtësit të të pandehurit, dhe të gjitha shkresat e tjera të lëndës, dhe ka vlerësuar se aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të tjera për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Gjykata arsyetoi faktet vendimtare, secilën provë veçmas, si dhe të gjitha së bashku, situata faktike është vërtetuar në bazë të provave materiale, dhe jomateriale dhe deklaratave të dëshmitarëve të dëgjuar”.

19. Avokatët e parashtruesit të kërkesës paraqitën në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, PKR. nr. 3/2017, të 25 tetorit 2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 341/2019, të 20 gushtit 2019, duke deklaruar se *“aktgjykimet e kundërshtuara janë nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitës së nenit 370, paragrafi 7 i KPK-së, ... si subjekt i veprës penale Krim i luftës kundër popullatës civile sipas nenit 142 të KP të RSFJ-së, mund të jetë një individ që jep urdhra, urdhërdhënësi ose kryerësi i drejtpërdrejtë i veprimeve të ndaluara, domethënë, gjëja kryesore në këtë vepër penale është formulimi se kush mund të jetë kryes i krimit, ndërsa sipas aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, mund të jetë çdo person, ... se për ekzistimin e veprës penale të krimit të luftës nevojitet që të kryhet shkelja e rregullave të së drejtës ndërkombëtare në lidhje me luftën dhe konventat ndërkombëtare të cilat i obligojnë pjesëmarrësit aktiv në luftë që t'i përmbahen rregullave të luftës dhe kësaj, fakti që i dënuari nuk ishte një pjesëmarrës aktiv në anën e ndonjë pale në konflikt, ai nuk mund të jetë kryerës i kësaj vepre penale”.*
20. Më 26 dhjetor 2019, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Pml. nr. 351/2019, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të avokatit të parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata Supreme konkludoi:

“... pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, as shkelje të ligjit penal të cilat pretendohen. Në shpjegimin e vendimit të saj, gjykata e shkallës së parë paraqiti qartë konkluzionet e saj në lidhje me veprën penale e cila i është vënë në barrë të dënuarit sipas aktakuzës, për më tepër, bazuar në dispozitën e nenit 142 të KP të RSFJ-së, ajo gjeti se veprimet e të dënuarit janë manifestuar të gjitha elementët objektive dhe subjektive ...

Edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, bazuar në përmbajtjen saj, janë paraqitur pretendime edhe për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo, këto pretendime nuk janë vlerësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, meqë bazuar në dispozitën e nenit 432, par.2 i KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar

edhe pretendimet e paraqitura në kërkesë përkitazi me shkeljet e dispozitës së nenit 370, par.7 të KPPK-së, mirëpo me këtë rast ka konstatuar se në kërkesë nuk ishte theksuar shkelja konkrete përveç faktit që ishte cituar dispozita ligjore, andaj për këtë arsye në kuptim të nenit 436 të KPPK-së, nuk shqyrtoi këtë pjesë të kërkesës meqë ishte e kufizuar në verifikimin e shkeljeve në kuptim të dispozitës së lartcekur”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon që autoriteti gjyqësor i ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara nga neni 3 [Barazia para Ligjit], neni 5 [Gjuhët], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës.
22. Gjykata nuk mund të vërejë në kërkesë se parashtruesi i kërkesës veçmas i ka theksuar ose ndërtuar pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave kushtetuese nga nenet e përmendura veçmas, por se ai i ndërtonte shkeljet e pretenduara të neneve të përmendura të Kushtetutës mbi pohimin “se Gjykata Supreme e Kosovës nuk i dorëzoi mbrojtësit të të pandehurit Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 35112019, të datës 26.12.2019, në gjuhën serbe, dhe se nuk e bëri këtë as deri në parashtrimin e ankesës kushtetuese, kështu që mbrojtësi mund vetëm të hamendësojë rezultatin e vendimit në fjalë të Gjykatës Supreme”.
23. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se “Subjekti i veprës penale të krimit të luftës kundër popullatës civile sipas nenit 142 LP RSJ-së, mund të jetë çdo individ i cili jep urdhra, urdhërdhënësi ose kryerësi i drejtpërdrejtë i veprimit. Pyetja themelore të cilën e shtroj në ankesën kushtetuese të paraqitur është “KUSH”??? mund të jetë kryerësi i veprës penale që “Krimi i luftës ndaj popullatës civile sipas nenit 22 dhe 142 të Ligjit penal të Republikës Socialiste të Jugosllavisë” sipas bindjes dhe besimit të mbrojtësit, ai mund të jetë vetëm individ i cili është pjesëtar i organizatës ushtarake, politike ose palës organizative të konfliktit ose madje edhe individ i cili gjendet në shërbim të palës e cila është në konflikt”.
24. Në mbështetje të kësaj, parashtruesi i kërkesës shton “Për ekzistimin e veprës penale të krimit të luftës, nevojitet që kryerësi i veprës të thyejë rregullat e të drejtës ndërkombëtare dhe konventat e luftës, sepse ato rregulla ndërkombëtare obligojnë pjesëmarrësit aktivë në luftë që t’i përmbahen rregullave të luftës. Pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë pjesëmarrës aktiv i asnjërës palë në konfliktin luftarak, ai nuk mund të jetë kryerës i veprës penale e cila i vihet në barrë”.
25. Gjykata nuk gjen në kërkesë se cila është kërkesa specifike e parashtruesit të kërkesës për Gjykatën, përkatësisht me cilat kërkesa paraqitet ai para Gjykatës. Sidoqoftë, duke pasur parasysh përmbajtjen e pretendimeve në kërkesë, mund të krijohet përshtypja se parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të përgjigjet se “KUSH” mund të jetë kryerës i veprës penale “Krime i luftës kundër popullatës civile”, sipas neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste të Jugosllavisë”.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Në vijim, Gjykata gjithashtu u referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ”.

29. Për më tepër, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës.

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]*

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit i është dorëzuar parashtruesit”.

30. Para se të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet të heqë disa dyshime dhe paqartësi të cekura nga parashtruesi i kërkesës, të cilat, si të tilla, në kuptimin procedural ia pamundësojnë Gjykatës që të marrë në shqyrtim pretendimet e parashtruesit në kërkesë. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës në kërkesë ka theksuar se ai nuk e kishte marrë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në gjuhën serbe, dhe kështu ai nuk ishte në dijeni të përmbajtjes së tij.
31. Pikërisht për të hequr këto paqartësi të para në lidhje me datën e dorëzimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 351/2019, në gjuhën serbe, Gjykata i dërgoi letra Gjykatës Supreme në dy raste, më 2 korrik 2020 dhe 26 gusht 2020, ku kërkonte që Gjykatës Kushtetuese t'i dorëzohej informacioni *“nëse Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 351/2019, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës ose mbrojtësve të tij në gjuhën serbe, nëse po kur i është dorëzuar, dhe nëse jo pse nuk i është dorëzuar”*.
32. Më 28 gusht 2020, Gjykata Supreme iu përgjigj kërkesës së Gjykatës duke deklaruar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 351/2019, i është dërguar me postë mbrojtësve të parashtruesit të kërkesës, dhe se më 10 janar 2020, atë e ka pranuar avokati Nebojsa Vlajić, me ç'rast ai gjithashtu ka nënshkruar konfirmimin e marrjes së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në gjuhën serbe. Në mënyrë që të vërtetojë deklaratimet e saj, Gjykata Supreme paraqiti gjithashtu edhe provën, përkatësisht dëftesën e pranimin të dërgesës së 10 janarit 2020, me nënshkrimin e avokatit Nebojsa Vlajić, si person që e ka pranuar vendimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 351/2019.
33. Nga kjo mund të konkludohet se afati për dorëzimin e kërkesës në Gjykatë llogaritet se ka filluar nga 10 janari 2020, përkatësisht nga dita kur, sipas konfirmimit të Gjykatës Supreme, Aktgjykimi Pml. nr. 351/2019 i ishte dorëzuar mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës.
34. Tutje, si një hap tjetër në aspektin procedural, Gjykata duhet të përcaktojë nëse kërkesa e parashtruesit të kërkesës është parashtruar në përputhje me afatet e përcaktuara nga neni 49 i Ligjit dhe rregulli 39 (1) (c) i Rregullores së punës.
35. Për këtë qëllim, Gjykata konstaton se parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë më 9 qershor 2020, me shpjegimin se *“duke u bazuar në vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kjo ankesë është parashtruar pas afatit të caktuar me ligj për shkak të pandemisë, sëmundjes COVID19”*, me ç'rast ai nuk i ofroi Gjykatës ndonjë shpjegim ose vendim tjetër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të cilit i referohet si e vetmja bazë ligjore të cilën Gjykata Kushtetuese duhet ta pranojë, dhe rrjedhimisht të pranojë të shqyrtojë kërkesën e tij të paraqitur pas skadimit të afatit prej 4 (katër) muajsh.

36. Në lidhje me këtë, Gjykata dëshiron të theksoj se është në dijeni të të gjitha rrethanave që kanë rrjedhur në lidhje me COVID-19, megjithatë, Gjykata gjithashtu dëshiron të shtojë se vendimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në lidhje me strukturën organizative të punës, së cilës i referohet parashtruesi i kërkesës, nuk ndikojnë në punën e Gjykatës Kushtetuese, e cila funksionon në përputhje me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese nr. 03/L-121, si dhe Rregulloren e punës të Gjykatës Kushtetuese, ku janë të përshkruara qartë kushtet ligjore dhe procedurale që rregullojnë punën e Gjykatës Kushtetuese.
37. Në mbështetje të kësaj, Gjykata veçanërisht dëshiron të shtojë faktin se, pikërisht për atë qëllim, më 16 mars 2020 ajo e lëshoi një "Njoftim" në lidhje me punën e Gjykatës Kushtetuese, me qëllim të informimit të qartë të të gjithë qytetarëve për ndryshimet organizative lidhur me punën e Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që të mos krijohen paqartësi ose dyshime në lidhje me punën e saj operacionale përkitazi me pranimin e ankesave kushtetuese.
38. Gjykata rikujton përmbajtjen e njoftimit të publikuar të 16 marsit 2020:

"Në përputhje me rekomandimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe duke marrë parasysh situatën e përgjithshme në vend, pas konfirmimit të rasteve të para me virusin COVID-19, Gjykata Kushtetuese vendosi të reduktojë aktivitetet e saj publike dhe zyrtare. Sidoqoftë, për të respektuar të drejtën e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës për të paraqitur ankesat e tyre kushtetuese dhe për shqyrtimin e tyre pavarësisht nga situata aktuale, Gjykata, gjatë kësaj periudhe, do të vazhdojë të punojë me një numër të reduktuar të stafit, të cilët do të jenë të pranishëm në vendet e tyre të punës. Të gjithë gjyqtarët do të vazhdojnë të punojnë nga shtëpitë e tyre dhe do të jenë në dispozicion për të shqyrtuar çdo kërkesë urgjente që mund të bëhet para Gjykatës. Gjithashtu, të gjithë këshilltarët e Gjykatës, si dhe zyrtarë të Sekretariatit, me përjashtim të atyre që do të jenë në detyrë në Gjykatë, do të vazhdojnë të punojnë nga shtëpitë e tyre, për aq sa do të jetë e mundur në rrethana të tilla. Prandaj, Gjykata Kushtetuese do të vazhdojë të pranoj parashtrësia si të qytetarëve ashtu edhe të të gjitha palëve të autorizuar gjatë orarit zyrtar të punës, si çdo ditë tjetër pune (08:00 - 16:00). Mirëpo, për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të virusit COVID-19, të gjitha palët e interesuara ftohen të paraqesin kërkesat e tyre, sipas mundësisë, në mënyrë elektronike, në postën elektronike zyrtare të Gjykatës: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org. Formulari i kërkesës si dhe udhëzimet për plotësimin e formularit të kërkesës mund të shkarkohen nga faqja e internetit e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org. Në lidhje me afatet për parashtrimin e kërkesës, Gjykata rikujton se në pajtim me nenin 50 të Ligjit nr. 03 / L-121 për Gjykatën Kushtetuese: "Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj".

39. Pikërisht nga njoftimi për opinionin i Gjykatës Kushtetuese i 16 marsit 2020 mund të konkludohet qartë se Gjykata Kushtetuese, me gjithë numrin e reduktuar të stafit në kohën e publikimit të njoftimit me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19, kishte paraparë mekanizma që nuk do të vinin në pikëpyetje të drejtat kushtetuese të palëve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, nëse mendojnë se të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese janë shkelur me vendim të ndonjë organi.
40. Për më tepër, Gjykata rikujton që Rregullorja e punës e Gjykatës Kushtetuese, më saktësisht rregulli 32 i Rregullores së punës, parasheh mënyrën e parashtrimit të kërkesave në Gjykatën Kushtetuese.

Rregulli 32. Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve

*(1) “Kërkesa duhet të parashtrohet me shkrim, në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës ose në njërën nga gjuhët me përdorim zyrtar në Kosovë. Do të përdoret formulari i kërkesës i publikuar në ueb-faqen e Gjykatës ose ekuivalenti i saj. Kërkesa i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm, duhet të përfshijë datën e parashtrimit të saj dhe të jetë e nënshkruar nga personi që e parashtron atë.
[...]*

(8) Kërkesa mund të parashtrohet personalisht në zyrën e Sekretariatit të Gjykatës, gjatë orarit të rregullt të punës, ose nëpërmjet postës apo mjeteve të komunikimit elektronik.

41. Bazuar në përmbajtjen e rregullit 32 të Rregullores së punës, mund të konkludohet se ai parasheh 3 (tre) mekanizma për parashtrimin e një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
42. Më konkretisht, përveç parashtrimit të një kërkesë personalisht në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me rregullin 32 të Rregullores së punës, një palë ka në dispozicion edhe mekanizma të tjerë për parashtrimin e kërkesës, përkatësisht a) parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese përmes postës së rregullt, dhe b) parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese përmes postës elektronike. Gjykata rikujton se për këtë qëllim në faqen e Gjykatës Kushtetuese është publikuar adresa në të cilën gjendet selia e Gjykatës Kushtetuese, e cila mund të përdoret për të dërguar kërkesa me postë, si dhe adresa e postës elektronike e Gjykatës Kushtetuese për të dërguar kërkesat në Gjykatën Kushtetuese në mënyrë elektronike.
43. Për më tepër, Gjykata dëshiron të theksojë se neni 50 i Ligjit parashikon mundësinë e *Kthimit në gjendjen e mëparshme*, ku Gjykata Kushtetuese obligohet të shqyrtojë një kërkesë, pavarësisht nga fakti se afati ligjor prej 4 (katër) muajsh ka skaduar.

“Neni 50 Kthimi në gjendjen e mëparshme

Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme.

Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj”.

44. Në bazë të nenit 50 të Ligjit, në mënyrë që të aprovohet kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme duhet të plotësohen kushtet në vijim: (i) parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se pa fajin e tij/saj nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, respektivisht brenda afatit prej 4 (katër) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit; (ii) parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës; (iii) parashtruesi i kërkesës ka për detyrë të arsyetojë kërkesën në fjalë; dhe, (iv) se nuk ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë. Këto kushte janë kumulative.
45. Pikërisht, me qëllim të përcaktimit nëse parashtruesi i ka plotësuar këto kushte të përcaktuara, Gjykata analizoi të gjitha pretendimet e parashtruesit dhe gjeti si në vijim: që sa i përket kushtit që përcakton obligimin që i) *“parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se pa fajin e tij/saj nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, respektivisht brenda afatit prej 4 (katër) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit”*, Gjykata është e mendimit se parashtruesi i kërkesës nuk e ka plotësuar këtë kusht të parë, duke marrë parasysh se në kërkesë nuk ka shpjeguar dhe as nuk ka dëshmuar se çfarë e ka pamundësuar ose parandaluar atë që të paraqesë kërkesën në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar. Për më tepër, ai as nuk e arsyetoi kërkesën e tij dhe as nuk dorëzoi çfarëdo dokumentacioni me të cilin do të tregonte se ai ishte parandaluar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që si pasojë e situatës së krijuar me COVID-19 nuk ka mundur të shfrytëzojë as mekanizmat alternativë për parashtrimin e kërkesave. Duke marrë parasysh se parashtruesi i kërkesës nuk e ka plotësuar kushtin e parë kumulativ, Gjykata konsideron se nuk ka nevojë të vazhdojë me vlerësimin se a janë kushtet e tjera të përcaktuara me nenin 50 të Ligjit.
46. Gjykata rithekson se e ka për detyrë të miratojë ose të mos miratojë kthimin në gjendje të mëparshme të afatit, në bazë të vlerësimit të vet, në secilin rast veç e veç, nëse janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nenin 50 të Ligjit e që janë kumulative. Në rrethanat e këtij rasti, në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vlerëson që (i) parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, respektivisht brenda afatit prej 4 (katër) muajsh të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, pasi që edhe pse nuk është kontestues fakti se erdhi deri te pandemia Covid-19, në kërkesën e tij nuk ka arsyetim për pamundësinë e parashtrimit të kërkesës në Gjykatë gjatë muajve prill dhe maj 2020, dhe për më tepër, nuk ka arsyetim për pamundësinë e parashtrimit të kërkesës në Gjykatë nga ana e avokatëve të cilët parashtruesi i kërkesës i ka pasur gjatë zhvillimit të procedurës e të cilët përmenden edhe në këtë kërkesë si përfaqësues të tij.
47. Duke pasur këtë në mendje, Gjykata vetëm mund të konkludojë se nuk kishte asgjë që e ka penguar parashtruesin e kërkesës për të parashtruar kërkesën në

Gjykatën Kushtetuese brenda afatit prej 4 (katër) muajsh, duke shfrytëzuar një nga mekanizmat për parashtrimin e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese, siç përcaktohet nga rregulli 32 i Rregullores së punës apo të përmbush kushtet e parapara nga neni 50 i Ligjit.

48. Prandaj, Gjykata duke pasur parasysh datën e dorëzimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 351/2019, e që është 10 janar 2020, si dhe datën e parashtrimit të kërkesës në Gjykatë, e cila është 9 qershor 2020, konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 351/2019, është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
49. Gjykata rikujton që qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, në përputhje me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është të promovojë sigurinë juridike, të sigurojë se rastet e ngritura për çështje kushtetuese do të shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për pranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24, dhe vendimin e GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë në rastin *Çelik kundër Turqisë*, parashtrës nr. 52991/99 e 23 shtatorit 2004).
50. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa nuk përmbush kushtet procedurale të pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe për këtë arsye, si e tillë, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 25 mars 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvetë Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi